



Laringiti kronik

Punoi : Dr. Jetona Sulaj

Udheheqes:

Prof. Asc. Suela Sallavaci

Tirane, Nentor 2015

Abstrakti

Laringiti kronik perben nje ceshtje bashkekohore me interes te madh, kryesisht per shkak te identifikimit te faktoreve te rindj etiopatogenik te lidhur me ndryshimin e ndotesve ambientale dhe produkteve tokiske te gjetura ne vendet e punes. Evoluimi i vazhdueshem i ketyre faktoreve perben nje sfide per ekspertet e mjekesise, te cilet duhet te perditesojne njohurite e tyre lidhur me materialet e reja tokiske/irritative qe perdoren ne tregun industrial. Nevoja per implementimin e strategjive te reja per te evidentuar efektet anesore ne organizmin e njeriut dhe perdonimi i terapive koriguese te domosdoshme, perben nje fushe kerkimi shume aktive. Ne te kundert, simptomat e laringitit kronik mund te jene prezente edhe ne popullaten e shendoshe.

Trajtimi i laringitit kronik perben nje problem te veshtere. Humbja e zerit, kolla kronike dhe obstrukioni i rrugeve ajrore jane respektivisht komplikacionet me te mundshme. Trajtimi logopedik ze nje vend me rendesi, kryesisht gjate rehabilitimit dhe vleresimit te zerit e gelltitjes, si p.sh. pas kirurgjise se laringut.

Permbajtja:

Laringiti kronik:

• Fizpatologjia.....	3
• Epidemiologjia.....	3
• Prezantimi klinik	
- Ankesat.....	4
- Anamneza e jetes.....	4
- Anamneza personale.....	4
- Anamneza familjare.....	5
• Ekzaminimi fizike.....	5
• Faktoret etiologjike dhe predispozues.....	6
• Diagnoza	
- Studimi laboratorik.....	9
- Studimi imazherik.....	9
- Teste te tjera.....	10
- Procedurat.....	10
- Gjetjet histologjike.....	10
• Diagnoza diferenciale.....	11
• Trajtimi	
- Kujdesi mjekesor.....	11
- Kujdesi kirurgjikal.....	12
- Konsultimet.....	12
- Dieta.....	12
- Aktiviteti.....	12
- Trajtimi me antibiotike.....	13
- Ndjekja jashtespitalore.....	13
- Ndjekja spitalore.....	13
• Komplikacionet.....	14
• Edukimi i pacienteve.....	14
➤ Tipe te laringitit kronik	
• Laringiti Sicca.....	14
• Nodujt vokale.....	15
• Polipi vokal i lokalizuar.....	17
• Edema Reinke.....	18
➤ Pakidermia e laringut.....	19
• Shtoje 1: Shkaktaret e laringitit nga inhalacioni.....	21
• Shtoje 2: Trajtimi per laringitin nga refluksi.....	22
• Bibliografia.....	23

Laringiti kronik i referohet nje procesi inflamator, i cili perbehet nga alterime te pakthyeshme te mukozes laringeale.

Fizpatologjia

Proceset reaktive dhe reparative perfaqsojne faktorin patogenik kryesor, qe mund te persistoje edhe ne mungese te stimulit shkaktar. Ne varesi te shkaktareve, gama e ndryshimeve mund te jete shume e ndryshme. Inflamacioni, edema, hiperemia, infiltrimi dhe proliferimi perfaqsojne nivele te ndryshme te cenimit te mukozes.

Procesi inflamator demton epitelin ciliar te laringut, vecanerisht ne murin posterior. Kjo cregullon procesin e rendesishem te levizjes se mukusit jashte pemes trakeo-bronkiale. Kur levizja e cilieve te epitelit eshte prishur, staza e mukusit ne murin posterior te laringut dhe perreth kordave vokale provokon nje kolle reaktive. Mukusi pergjate kordave vokale mund te manifestohet edhe me laringospazme. Strukturat glandulare pesojne hipertrofi, qe ne stadet e hershme te semundjes, ndersa me vone ndodh atrofia e plote e cila con ne sindromin Sicca. Indet subepiteliale paraqesin shkalle te ndryshme te vazodilatacionit, hemoragjise, edemes intersticiale dhe infiltrimit qelizor mononuklear. Ne rastet e zgjatura te semundjes jane te pranishme fibroza subepiteliale dhe degjenerimi hialin. Ndryshime domethenese mund te prekin epitelin e kordave vokale, ne formen e hiperkeratozes, diskeratozes, parakeratozes, akantozes dhe atipise qelizore. Si pasoje e ketyre ndryshimeve ndodh c'rregullimi i funksionit vokal per shkak te afritimit jo te rregullt te kordave vokale, duke cuar ne insuficience aerodinamike dhe si pasoje ndryshim te cilesise se zerit.

Epidemiologjia

Nuk ka te dhena te sakta ne lidhje me frekuencen e laringitit kronik, pasi zakonisht konsiderohet si pjese e nje patologjie me komplekse, pra raportohet me pak.

Lidhja mes laringitit kronik dhe kancerit te laringut eshte e paqarte. Vdekshmeria eshte e lidhur me patologjine kryesore te cilën shoqeron laringiti kronik. Kjo gjendje i prek te gjitha racat njesoj. [\(1\)](#)

Tradicionalisht, meshkujt preken me teper se femrat. Ne raportimet e fundit, vazhdon te ruhet rapporti 2:1, edhe pse trendi po ndryshon, probabilisht per shkak te shtimit te grave duhanpirese dhe rritja e perfshirjes se tyre ne aktivitete pune ne ambjente tokiske.

Preken kryesisht adultet ne dekaden e gjashte te jetes. Neonatet dhe infantet ndajne te njejtet faktoret riku si adultet ne zhvillimin e laringitit kronik. Gjithashtu, lezione te ndryshme kongenitale te laringut mund te shfaqen me ndryshime te zerit.

Prezantimi klinik

Ankesat

Simptomat dhe shenjat e kane origjinën nga alterimet funksionale anatomike te laringut dhe nga perfshirja e strukturave perreth. Kur laringiti kronik eshte një manifestim i një semundje sistemeke, atehere predominojnë stigmata e procesit patologjik kryesor.

- Me shpesh janë pershkruar ngjirja e zerit dhe disfonia. Cilesia dhe sasia e zerit mund të variojne, edhe pse sherimi i plote nuk ndodh kurre.
- Kolla kronike eshte raportuar me e theksuar gjate nates. Nese shkaktari eshte Refluksi gastroezofageal (RGE), kolla mund të pershkruhet si e thate ose produktive me sasi të vogla mukusi, ne varesi të perfshirjes se murit posterior te laringut. Verehet ndryshimi i ngjyres se mukoza se laringut e cila zbardhet.
- Stridori i shkaktuar nga laringospasma mund të shfaqet nëse mukusi qendron per gjate kordave vokale.
- Disfagia dhe otalgia verehen me perfshirjen e faringut, per shkak të ndarjes se inervimit midis fytit dhe faringut.

Anamneza e jetes

- Duhanpirja, drogat rekreacionale dhe abuzimi me alkoolin
- Ndonje praktike qe te perballë me rishkin ndaj semundjeve infektive, si p.sh. faktor rishku per HIV/AIDS, sifiliz, etj
- Dieta, me vemandje te vecante ne konsumimin e cokollates dhe kafeines qe mund te shkaktojne relaksimin e sfinkterit te poshtem ezofageal, duke precipituar keshtu ne laringit irritativ dhe RGE

Anamneza personale

- Koha e instalimit te simptomave, cilesia dhe variacioni i tyre per gjate ekspozimit ndaj faktoreve precipitues dhe lehtesues
- Gjendja e per gjitshme shendetesore, simptomat dhe shenjat e semundjes se tiroides apo kanceri i mushkerive, dhe cdo gjendje tjeter shendetesore qe mund te sjelle ose te imitoje laringitin kronik
- Historia e punes, perfshire kontaktin me substancë tokrike, tymra, pluhura dhe ndryshimet e shpejta te temperaturave
- Abuzimi me zelin, i lidhur me profesionin ose jo
- Piroza, regurgitimi, disfagia, kolla, wheezing, ngjirja, dhimbja e kraharorit ose otalgia ngrënë dyshimet per patologjine e RGE. Duke iu referuar një publikimi, mjeket ORL qe

kane diagnostikuar laringitin lidhur me RGE shpesh besojne ne prezencen e globusit dhe pastrimit te fytit.(2)

- Prezenca e astmes duhet te alarmoje mjekun per mundesine e disfunkzionit te kordave vokale (p.sh. historia e shtrengimit te fytit dhe jo e kraharorit, veshtiresi ne fonacion, stridor laringeal dhe wheezing me te theksuara ne inspirim), alergjite, RGE ose procese te perfshirjes se pemes trakeobronkiale
- Pershkrimi ose teprimi me medikamente (p.sh. diuretike, antihipertensive, barna psikotrope, antihistaminike, dekongestionant) qe mund te shkaktojne predispozite ose te determinojne vendosjen e laringtit kronik. Keto preparate mund te shkaktojne tharje dhe/ose demtim te mukozes. Nese pacienti paraqet nje histori imunosupresioni ose perdorimi ne rruge inhalatore te steroideve, atehere mund te dyshohet si shkaktar i laringtit Candida.
- Medikamentet (si p.sh. calci bllokusit, nitratet, beta bllokusit, progesteroni) mund te shkaktojne predispozicion per RGE duke ulur tonusin e sfinkterit te poshtem ezofageal. (Fuchs and Bucheler kane pershkruar nje rast laringiti hiperplastik, qe ka pasuar perdorimin e zgjatur te Cibacen 10, nje ACE-i (3))
- Trajtimet inhalatore, si ne banjat termale
- Histori kirurgjikale, vecanerisht ne rastet e intubimit : Rreziku i demtimit jatrogjenik i nervit laringeal recurrent me rezultat disfonine, gjate kirurgjisë torakale dhe abdominale. Gjate ketyre kirurgjive mund te shkaktohet edhe nje alterim anatomik konsekuent, qe mund te behet predispozite per RGE.
- Histori traume te qafes
- Administrim i substancave kaustike
- Histori udhetimi, per mundesine e nje infeksioni parazitar

Anamneza familjare

- Historia familjare eshte me rendesi kur dyshohet per nje patologji autoimune (p.sh. amyloidosis, LES, granulomatoza Wegener, AR).
- Simptoma te ngjashme ne pjestare te tjere te familjes ndihmojne per te identifikuar ndotes te mundshem ambjental perqejges per laringitin kronik.
- Pjestaret e familjes duhet te ekzaminohen per ndonje patologji infektive me potencial per tu perhapur, si tuberculozi.

Ekzaminimi fizik

Aparanca e per gjithshme dhe shenjat vitale mund te na sigurojne te dhena te dobishme.

- Duhet te evidentohet perdorimi i muskujve aksesore gjate respiracionit, ne rast prezence. Mund te kerkohet auskultimi i rrugeve respiratore dhe matja e puls

oksimetrise. Ne rast infekzioni, mund te jene prezent temperatura ose parametra qe indikojne tokscitet.

- Nje ekzaminim i mire i kokes dhe qafes eshte fondamental. Vemendje e vecante ndaj masave dhe limfadenopative mund te ndihmoje per te lokalizuar patologjite malinje. Duhen vleresuar gjendra tiroide dhe kartilagot laringeale dhe trakeale.
- Laringoskopia indirekte duhet realizuar ne nje ekzaminim fizike rutine. Teknikat direkte na mundesojne nje ekzaminim me te mire te laringut, perdonimi i endoskopise fleksibel ne pacientet zgjuar dhe laringoskopia rigide ne pacientet nen anestezi gjenerale. Lokalizimi i procesit inflamator ne laring haset rralle, edhe strukturat perreth mund te perfshihen. Disa mjeke ORL me shpesh besojne ne gjetjet jo specifike te eritemes dhe edemes laringeale, per te diagnostikuar dhe trajtuar laringitin e lidhur me RGE.(2) Vemendje e vecante duhet ti kushtohet bazes se gjuhes, tonsilave, nazofaringut dhe sinuseve per te gjetur nje burim eventual primar infekzioni. Pema trakeobronkiale dhe pulmonet duhen konsideruar si nje burim potencial infekzioni. Mukus (kryesisht ne murin posterior te laringut), eritema dhe enjtja jane gjetjet me te zakonshme ne laringitin jospesifik. Pusi mund te jete prezent ne infekzionet bakteriale. Shume gjendje mund te duken te ngjashme, si histoplasmosa dhe blastomykoza, te cilat jane infeksione te shkaktuara nga funget qe mund te imitojne tuberkulozin apo kancerin me qeliza skuamoze te laringut. Duhet ekzaminuar epiglotisi dhe kordat vokal. Kjo e fundit duhet te vleresohet edhe gjate fonacionit. Ekzaminimi stroboskopik ndihmon ne determinimin, nese ngurtesimi i mukozes eshte sekondar nga hiperplazia e epitelit apo inflamacioni kronik.

Faktoret etiologjike dhe predispozes:

- Duhanpirja irriton kronikisht mukozen laringeale. Ne ekstreme, mund te shkaktoje kancer.
- Etanol i permbar shume papasterti, si mycotoxina, tanina, aldehyde dhe pesticide, te cilat mund te shkaktojnë kancer, si nga kontakti i drejtperdrejt me mukozen ose nepermjet nje efekti sistemik, ose duke luajtur rolin e nje irritanti.
- Patologjia e RGE
Laringiti kronik i lidhur me RGE eshte vecanterisht i rendesishem. Irritanti eshte permbajtja gastrrike dhe pjesa kryesore e demtimit ndodh gjate nates, kur pacienti qendron shtrire. Muri posterior i laringut eshte me i prekuri ne RGE, edhe pse procesi mund te perfshije cdo pjese te epitelit te traktit te siperm respirator. Diagnoza mund te vendoset pas perjashtimit te shkaqeve te tjera dhe pas konfirmimit permes studimeve

te duhura te pH. Pavarsisht faktorit etiologjik te refluksit, ne cdo rast ai mund te sjelli laringit kronik.

- Infekzionet

Bakteri i izoluar zakonisht ne infekzionet kronike te laringut eshte *Staphylococcus aureus*. *Haemophilus influenzae* dhe tipet e pneumokokeve mund te komplikojne seurine e laringitit viral.

Tuberculosi i shkaktuar nga *Mycobacterium tuberculosis* hominis ka qene nje patologji e zakonshme e laringut. Gjithsesi incidencia ka rene. Rruga haematogjene dhe infektimi i sputimit nga tuberculosi pulmonar jane burimet me te zakonshme te infekzionit.

Leproza e shkaktuar nga *Mycobacterium leprae*. Ky bacil ka tendence per te invaduar nervat dhe per te prekur laringun. Rruga e hyrjes mendohet te jete mukoza nazale; per rrjedhoje perforimi eshte i zakonshem. Laringu eshte i dyti qe preket zakonisht.

Sifilizi, i shkaktuar nga bakteri *Treponema pallidum*. Sifilizi ka tre stade: primar, ku shankri eshte gjetja klinike kryesore; secondar, ne te cilin predominojn perfshirja sistemike dhe kutane; dhe treciar, ne te cilin prevalojne proceset joinfektive destruktive. Laringu perfshihet ne stadin e dyte dhe te trete. Perfshirja laringeale ne sifilizin kongenital eshte pare te jete e ngjashme me ate ne sifilizin secondar.

Rhinoscleroma nga gram-negativi *Klebsiella rhinoscleromatis*.

Aktinomykoza, nje semundje granulomatoze e shkaktuar nga bakteri anaerob gram-pozitiv *Actinomyces israelii*, eshte pjese e flores normale orofaringeale dhe mund te manifestohet si nje absces.

Viruset, edhe pse me te rendeshishmet ne determinimin e laringitit viral, luajne nje rol te vogel ne etiologjine e laringitit kronik.

Infekzionet nga funget Jane shume te zakonshme. Kryesisht preken pacientet e imunokompromentuar, qofte natyrshem qofte si pasoje e trajtimeve farmakologjike.

Funget mund te gjenden ne siperfaqen e mukozes se laringut, ose ata mund ta invadojne ate. Imunosupresioni mund te jete kongenital ose i fituar dhe mund te derivoje nga AIDS. Imunosupresioni mund te jete i induktuar nga preparatet, si antibiotike, steroid, agjent kemoterapeutik ose sekondar si pasoje e radioterapise.

Laringiti kandidoz manifestohet me faringit si pasoje e kolonizimit te mukozes, perfshihet shpesh edhe kaviteti oral. Ne nje pacient me inhalacion steroidesh, laringu mund te jete i vetmi i perfshire.

Infekzionet invazive mund te shfaqen, si blastomycosis dhe histoplasmosis, te cilat Jane kondicione endemike ne disa rajone. Ne US, *Histoplasma capsulatum* and *Blastomyces dermatitis* jane prevalente ne zonen e lumit Ohio (histoplasmosis) dhe ne pjesen jugperendiore te US (blastomycosis).

Paracoccidiiodomycosis, coccidiosis, aspergillosis dhe rhinosporidiosis perbejne disa fungë pak te perfshira ne zhvillimin e laringitit kronik nga funget.

Raste sporadike te laringitit te shkaktuar nga infeksione parazitare, si leshmanioza dhe sporotrikoza, jane pare tek turistet kur kthehen nga zona te caktuara.

Kania ka raportuar per nje limfome primare MALT te laringut, e shoqueruar me RGE, laringit kronik dhe infekcion gastrik nga Helicobacter pylori.(4)

- Abuzimi me zerin mund te varet nga profesioni kengetar ose te bertiturat rastesore. Lezionet varojne nga edema te thjeshta, ne abuzuesit rastesor dhe deri te reaksionet hyperplastike nese stimuli persiston ne kohe.
- Pergjigjet alergjike ndaj tipeve te hipersensibilitetit te hershem apo te vonuar mund te shkaktojne laringit kronik. Edhe pse studiuesit nuk kane arritur ne shifra ekzakte te te prekurve, aktualisht mendohet se prevalanca eshte ne rritje.
- Faktoret ambientale, si pluhurat, tymrat, kimikatet dhe toksinat mund te shkaktojne laringit kronik. Laringiti kronik eshte diagnostikuar ne shume njerez, te cilet 20 vjet me pare kane inhaluar sulfur mustard, nje agjent alkilant te perdorur gjate lufteve Iran-Irak (1983-1988).(5)
- Semundjet sistemike, kryesisht autoimune mund te shkaktojne laringite kronike.
Granulomatoza Wegener: Laringu mund te preket nga inflamacioni dhe granulomat. Mund te lokalizohet duke prekur vetem rruget e siperme respiratore. Klinikisht, patientet mund te prezantohen me haemoptizi, stridor dhe stenoze te pasqyregjueshme te rrugeve te siperme respiratore, ne varesi te shkalles se perfshirjes. Biopsia nuk eshte gjithmone diagnostikuese.
Amylidoza: Depozitimet amyloide mund te perfshijne laringun dhe traktin e siperme aerodigestiv. Patientet mund te prezantohen me simptoma te obstruksionit te rrugeve te siperme respiratore, dispne dhe ngjirje zeri. Amyloidi mund te shkaktoje brishtesi vaskulare dhe per pasoje hemorragji.
Polikondritet relapsuese: Preken kryesisht adultet ne dekaden e peste te jetes. Mund te prezantohen me ngjirje zeri, obstruksion te rrugeve respiratore dhe dhimbje. Klinikisht laringu mund te jete i bute. Simptomat dhe shenjat jane sekondare si pasoje e inflamacionit dhe fryrjes se zonave glotike dhe subglotike. Inflamacioni i perseritur mund te perfundoje ne trakeomalaci.
- Laringiti kronik mund te shoqerohet edhe me semundje kutane. Laringu dhe lekura ndajne karakteristika te ngjashme mikro e makroskopike. Pemphigus, sindroma Stevens-Johnson, LES dhe epidermoliza buloze jane nder patologjite me te rendesishme.
LES mund te manifestohet me ulceracione laringeale, eritema dhe edema. Mund te shihen nodulat te tipit rheumatoid dhe vasculiti nekrotizant.
Me AR, nyjet dhe mukoza e laringut mund te preken me te njejtin probabilitet si gjithe pjeset e tjera te trupit.

- Shkaqet neurologjike mund te kontribuojne ne laringitin kronik. Dy dege te nervit vagus inervojne laringun, n.laringeal superior dhe n.laringeal recurrent. Alterimet ne inervim dhe ne muskulaturen e laringut shkaktojne levizhmeri anormale te komponenteve te ndryshem te laringut, me rezultat irritimin. Pritshmerite e mundshme perfshijne : paralizen unilaterale te n.vagus ose te n.laringeal recurrent ; paralizen abduktore bilaterale, pothuajse ne te gjitha rastet e shkaktuar nga kirurgjia ekstensive e gjendres tiroide, me demtim te n.laringeal recurrent ; paraliza n.laringeal superior, zakonisht pason tiroidectomine dhe laringectomine supraglotike.
- Disfonia spastike eshte nje crregullim i vecante i zerit, qe karakterizohet nga sforcimi e atake te bllokimit te zerit. Instalimi ndiqet nga nje periudhe stresuese ne moshen e mesme. Kjo gjendje eshte probabilisht nje ekspresion vokal i nje sjellje psikoneurotike dhe/ose nje crregullim proprioceptiv i laringut.
- Atrofia e kordave vokale dhe humbja e tensionit me moshen, shkaktojne ndryshime ne fonacion. Humbja e elasticitetit te ligamentit tiroaritenoid sjell kufizimin e frymemarrjes dhe humbjen e saj, si pasoje e perthyerjes se kordave vokale.
- Crregullimet muskulare mund te kontribuojne ne laringitin kronik. Dobesia e laringut dhe faringut eshte prezente ne 1/3 e pacienteve me myastenia gravis.
- Laringiti mund te jete edhe sekondar si pasoje e pellagres.(6)

Diagoza

Studimi laboratorik

- Gjak komplet
- Kulture sputumi dhe sensitiviteti per bakteret, funget dhe viruset
- Material nga mukoza laringeale, kulture dhe sensitiviteti per bakteret, funget dhe viruset
- Markuesit serologjik te crregullimeve autoimune
- Studim per tuberculosin dhe sifilizin kur merren ne konsiderate disa kushte

Studimi imazherik

- Radiografia e planit lateral te qafes mund te ndihmoje ne vizualizimin supraglotik, fyrjen retrofaringeale dhe densitetin e indeve te buta te rrugeve respiratore subglotike. Ndihamon vecanerisht ne emergjencia.
- Radiografia torakale
- CT-scan dhe MRI evidentojne me mire alterimet e indeve te buta dhe sigurojne informacionin me te mire referuar struktura se laringut.

- Studimi me barium, double-kontrast i traktit te siperm GI dhe manometria perdoren shpesh per te vleresuar manifestimet e RGE.
- Videostroboscopia eshte probabilisht studimi i vetem i rendesishem pas perjashtimit te nje tumori. Siguron nje informacion domethenes te vibrimit te kordave vokale, qe mund te regjistrohet ne monitor.

Teste te tjera

- Testet e lekures nese dyshohet per alergji
- Monitorim 24 ore i pH, nese RGE eshte ne DD

Procedurat

Laringu mund te ekzaminohet me laringoskopine indirekte dhe direkte me nazofaringolaringoskop fiberoptik fleksibel. Laringoskopia direkte me nje laringoskop rigid (nen anestezi gjenerale) mund te kerkohet per nje inspeksion te detajuar te laringut dhe per te perfthuar inde per biopsi, kulture dhe pjeseza per te identifikuar prezencen e organizmave. Ky ekzaminim duhet realizuar kur deshtojne studimet e tjera joinvazive.

Per te arritur nje vleresim te mire te traktit aerodigestiv, mund te kerkohet bronkoskopia dhe ezofagoskopia. Ekzaminimi stroboskopik ndihmon per te diferencuar ngurtesimin sekondar te mukozes nga hiperplazia epiteliale, qe mund te jete shkaktuar nga inflamacioni kronik. Ekscizioni endoskopik i polipeve dhe liza e adezionit realizohen kirurgjikalisht.

Nje studim i Witt sugjeron se nje analize e mire e pamjeve laringoskopike mund te perdoret per te diagnostikuar refluksin laringofaringeal ne pacientet me laringit kronik. Studimi qe perfshiu 20 paciente me refluks laringofaringeal dhe 42 kontolle, perdori llogaritjen e nuances dhe filtrin dy-dimensional Gabor per te vleresuar ngjyren dhe perberjen e tipareve te imazhit, me nje saktesi te kalsifikuar si 80,5 % kur ngjyrimi dhe perberja u vleresuan se bashku.[\(7\)](#)

Gjetjet histologjike

Shpesh nje ekzaminim histologjik nuk mund te evidentoje mundesite e ndryshme. P.sh. laringiti nga refluksi dhe pakidermia e shoqeuar me nje duhanpirje te zgjatur paraqiten me nje tablo te ngjashme klinike. Ne te dy rastet, predominojne infiltrate qelizore akute dhe kronike, me ose pa hiperplazi epiteliale. Modele te ndryshme te per gjigjes kronike indore rezultojne nga demtimet e meposhtme:

- Cregullimet infiltrative (amyloidoza). Proteinoza lipoide e laringut, e perfaqesuar nga depozitat e hialines mund te imitoje nodujt e kengetareve apo laringitin kronik.[\(8\)](#)

- Semundjet granulomatoze kronike (sarkoidosis, tuberculosis, laringiti fungoid).
- Inflamacion kronik jospecifik (laringiti bakterial, laringiti sicca)
- Proseset proliferative qe perfshijne shtresen epiteliale, hiperkeratoza, diskeratoza, parakeratoza, akantoza dhe atipia qelizore mund te shkaktojne nje per gjigje indore kronike. Tabloja klinike me ekstreme eshte ulceracioni laringeal dhe prezenca e granulomave.

Diagnoza diferenciale

- Kondronekroza e laringut
- Granuloma kontakti
- Stenoza glotike
- Cikatricet jatrogjenike te kordave vokale
- Stenoza subglotike te adultet
- Sulcus vocalis
- Lezionet vaskulare te kordave vokale
- Kistet e kordave vokale

Trajtimi

Kujdesi mjekSOR

Terapite me medikamente drejtuar kryesisht kunder agjenteve shkaktare variojne nga rasti ne rast. Ne RGE perdoren kryesisht antagonistet e receptoreve H₂, inhibitoret e pompes protonike dhe prokinetiket. Nje studim deshtoi ne sigurimin e evidencave per te perkrahur trajtimin me esmoprazol 40 mg 2 here ne dite per 16 javë, krahasuar me placebo per laringitin kronik posterior.(9). Masat ndihmese perfshijne:

- Hidratimi me rreth 2 litra likide ne dite
- Lageshtimi i dhomes
- Shmangia e ndotesve dhe substancave irritative/toksiqe
- Identifikimi dhe shmangia e sensitivitetit ambiental e ne vendin e punes: Ekspozimi i limituar ose ndryshimi ne ambientin e punes nese tymrat e demshem dhe tretesit organike jane per gjegjes
- Shmangia e duhanpirjes edhe si tymoses pasiv.

Kujdesi kirurgjikal

Nga nje kendveshtrim terapeutik, mund te indikohen procedurat e me poshtme:

- Reduktimi i stenozez indikohet kur proceset infiltrativ dhe gjendje, si amyloidoza, granulomatoza Wegener, AR apo LES ngushtojne ne menyre domethenese lumenin e laringut. Mund te kerkohen intervente kirurgjikale agresive.
- Ekscizioni kirurgjikal i masave ekzofite
- Aplikimi i Lazerit
- Kirurgjia laparoskopike antirefluks, duke perdonur tekniken fundoplikacion Nissen ka arritur rezultate te vlefshme ne RGE.

Konsultimet

Konsultimet me specialitetet e me poshtme mund te jene te nevojshme:

- Alergologu, vecanerisht kur inflamacioni kronik i laringut dyshohet te jete sekondar nga ndonje alergji dhe/ose ndotes
- Gastroenterologu
- Pneumologu, vecanterisht per shkak te granulomatozes Wegener, LES, AR dhe astma prek jo vetem laringun, por edhe pulmonet.
- Logopedi, per terapine e te folurit, vecanerisht ne vleresimin dhe rehabilitimin e zerit dhe gelltites, si pas kirurgjise laringeale. Qellimi i terapise se te folurit kerkon te arrije zerin me te mire te mundshem dhe clirimin nga simptomat vokale, qe shqetesojne pacientin. Kohezgjatja e terapise se te folurit varion nga $\frac{1}{2}$ -1 ore, ne varesi te pacientit. Per disa lloj cregullimesh te zerit, dy ose me shume seanca ne javje jane ideale per javet e para dhe me progresin e terapise, seancat rrallohen. Kohezgjatja e terapise eshte individuale, nga pak seanca, ne 12 javje ose me shume.

Dieta

Nese ekziston veshtirsia ne gelltite, atehere pacientet duhet te ushqehen duke iu referuar rekomandimeve te nje logopedi pas vleresimit te duhur te gelltites. Ne RGE, duhet evituar yndyra, alkooli, kafeina. Duhen evituar ushqimet qe mendohet se luajne rol alergjik ne patogenezen e laringtit kronik

Aktiviteti

Ne rast RGE, duhet evituar cdo zakon apo aktivitet qe shkakton refluks, si p.sh. pozicioni shtrire pas nje vakti te bollshem apo levizje qe rrisin presionin intra abdominal. Ngritja e kokes se krevatit ndihmon gjithashtu. Pas zgjidhjes se shkaktareve te laringtit kronik, te trajtuar

klinikisht dhe kirurgjikalish, rehabilitimi i zerit nen kujdesin e terapeutit te te folurit eshte hallka me me rendesi.

Trajtimi me antibiotike

S.aureus eshte nga organizmat me te zakonshem shkaktare te laringtit kronik bakterial. Terapia antimikroiale duhet te mbuloje patogenet gram-pozitiv dhe gram-negative.

Amoxicillin and clavulanate

Siguron mbulim te gjere te gram+, gram- dhe floren anaerobe. Femijet mbi tre muaj, llogaritja e dozes bazohet ne permbajten e amoxicillines. Per shkak te raporteve te ndryshme amoxicillin/acid clavulonic ne 250 mg tab(250/125) vs 250 mg tab te pertypshme (250/62.5), nuk perdoret tab 250-mg derisa femija te jete mbi 40kg.

Ndjekja jashtespitalore

- Kerkohet kur mbarevajtja e terapise nuk eshte optimale dhe kur besohet qe verifikimi eshte i domosdoshem.
- Kerkohet kur rekomandimet profilaktike dhe epidemiologjike duhet te perforcohen, p.sh lenia e duhanit, izolimi ajror dhe trajtimi mjekesor per familjaret e nje pacienti me tuberkuloz, etj.
- Kerkohet kur mjeku do qe te sigurohet qe gjetjet patologjike te laringut po regredojne duke u bazuar ne pritshmerite e planit te trajtimit.

Ndjekja spitalore

- Pranimi spitalor eshte i domosdoshem kur ekzistojne shenjat e simptomat e toksemise dhe kur kerkohet antibiotikoterapia intravenoze
- Monitorimi ICU mund te kerkohet ne prezence te stridorit ose te cdo simptome tjeter qe sugeron nje perfshirje te rendesishme te rrugeve respiratore. Kjo mund te verehet ne stendet e fundit te semundjeve, si granulomatoza Wegener, AR, polikondriti i perseritur, amyloidoza apo ne situata qe kompromentojne seriozisht strukturen dhe funksionin e laringut. Monitorimi i rrugeve ajrore merr nje rendesi supreme.
- Kur ekziston risku i aspirimit, mund te perdoren forma alternative te ushqyerjes derisa riku te ulet.
- Kur dyshohet per semundje kontagioze, duhen implementuar procedurat e duhura te izolimit para identifikimit te organizmit per gjegjes dhe fillimi i trajtimit mjeksor.
- Kerkohet edhe ne te gjitha rastet kur verifikimi i pergjiges ndaj terapise dhe optimizimi nevojiten.

- Nqs laringiti kronik eshte pjesa e nje semundje sistemike, atehere plani i trajtimit duhet te kete ne konsiderate nevojat e ndryshme qe variojne nga rasti ne rast.

Komplikacionet

Problemet me te veshtra qe shfaqen ne pacientet me laringit kronik, jane:

- Perhapja sistemike ose perhapja ne strukturat perreth e procesit infektiv eventual
- Stenoza laringeale e shkaktuar nga mbivendosja e infekzioni akut dhe edema konsekuente ose stenoza sekondare per shkak te nje procesi te zgjatur ne kohe te pa determinuar.
- Rritja reaktive tej mase e kordave vokale dhe demtimi permanent i struktureve se tyre, per rrjedhoje edhe i funksionit te tyre
- Transformimi ne kancer

Edukimi i pacienteve

- Evitimi i duhanpirjes aktive dhe pasive eshte i nje rendesie te madhe.
- Informacion i detajuar lidhur me substancat ne ambjentin e punes dhe ate rrethues, si dhe evitimi i zakoneve qe mund ti kene shkaktuar pacienteve laringitin kronik. Duhet te mesohen strategjite per te shmangur faktoret shkaktare dhe konsekuencat e tyre.
- Konsulte me logopedin kur nevojitet rehabilitimi i zerit. Rekomandohet perdorimi adekuat i zerit.
- Edukimi i pacienteve lidhur me marrjen e duhur te medikamenteve. Kortikosteroidet me inhalacion mund te shkaktojne laringit kronik, prezumohet per shkak te efektit imunosupresiv lokal, duke shkaktuar keshtu kandidoze orale. Kortikosteroidet me inhalacion mund te shkaktojne disfoni, probabilisht sekondare nga efekti miopatik. Keto efekte mund te minimizohen nepermjet reduktimit te dozes, nderrimi ne administrim 2 here ne dite, shqlarje te gojes, etj
- Pacientet duhet te jene te vetedijsphem qe obeziteti perben nje faktor riscu per zhvillimin e RGE, probabilisht i lidhur me rritjen e presionit intra-abdominal.

Tipe te laringitit kronik (10)

***Laringiti Sicca* (laringiti kronik atrofik)**

Kjo forme e laringitit karakterizohet nga nje tharje e theksuar e indit laringeal dhe atrofi, pothuajse gjithmone shoqerohet me krustezimin e mukusit. Shfaqet me shpesher tek duhanpiresit, gjate dehidrimit, ekspozimit te zgjatur ndaj ndotesve, tek femrat nga

hipoestrogenemia, si pjese e sindromit Sjorgen, gjate shtatzanise dhe mund te shoqeroje rinitin atrofik dhe ozenen.

Manifestimet klinike

Crregullimi fiziologjik kryesor eshte mungesa e sekrecioneve glandulare dhe lubrififikimit te mukozes. Pacienti ankon tharje dhe kruarje te fytit. Ka kolle persistente dhe perpiqet te nxjerre sekrecione te trasha dhe viskoze. Kolla dhe ngjirja jane me te shprehura ne mengjes. Ne ndonje rast krustat laringeale mund te shkaktojne veshtiresi respiratore dhe kur ato shkeputen mund te shkaktojne haemoptizi. Ngjirje dhe gervishtje fytit. Krustet jane vecanerisht te pranishme ne hapesiren interaritenoide dhe subglotike.

Trajtimi

Laringiti Sicca eshte nje patologji e veshtire per tu menaxhuar. Si fillim duhen evituar duhanipirja, ekspozimi ndaj ndotesve. Trajtimi eshte kryesisht simptomatik dhe konsiston ne rradhe te pare ne lubrififikimin dhe lageshtimin e laringut. Lageshtimi i mjedisit ku jeton, kryesisht naten. Heqja e krusteve jep nje ndjesi clirimi. Mund te perdoren agjente te ndryshem mukolitik apo inhalimi i mentolit, per zbutjen e krusteve.



Pamje thuajse ne subglotis, qe tregon se krustet e mukusit te verdhe jane aderuar direkt nen siperfaqene kordave vokale, poshte buzeve te tyre te lira.

Nodujt vokale

Nodujt vokale jane rritje beninje siperfaqesore, e lokalizuar ne mesin e pjeses membranoze te kordave vokale te verteta, qe besohet zakonisht te jene rezultat i fonotraumes. Nodujt jane kryesisht bilateral. Hasen kryesisht te femrat e moshes 20-50 vjec dhe te femijet (me shpesha te djemte) si pasoje e te bertiturave te shumta.(11)

Fizpatologja

Formimi i nodujve vokale eshte i lidhur me anatomin e kordave vokale te verteta. Nen shtresen epiteliale ndodhet nje hapesire subepiteliale, e quajtur Spatium Reinke. Kjo hapesire mbushet lehte nga likidet ose gjaku ne rastet e traumes vibratore gjate abuzimit vokal. Meqenese nodujt jane demtime reaktive ne perpjigje te traumes mekanike ato parashikohen si pasqyrim i ndryshimeve inflamatore progresive. Enjtjet nodulare akute mbulohen me epitel normal skuamoz, por stroma nen te mund te kete shkalle te ndryshme te edemes, vaskularitet te rritur, ene te dilatuara dhe hemorragji duke arritur keshtu ne stadin fuziform dhe ndonjehere hiperemik te zhvillimit te prenодујве. Ne kontrast me keta noduj, nodujt e maturuar jane me te forte per shkak te fibrozes dhe hialinizimit. Nodujt e maturuar te pare ne kengetaret profesioniste jane fibroze dhe te zbehte. Siperfaqja e epitelit trashet dhe mund te jene te pranishme keratoza, akantoza dhe parakeratoza.


Manifestimet klinike

Shenja e pare klinike e pranise se nodujve vokale eshte ndryshimi i zerit te kengetarit. Ata ankojne per ulje te qendueshmerise vokale, rriten perpjekjet per te produar ze, kane veshtiresi ne kenget qe kerkojne ze te larte dhe ngjirje zeri. Ekzaminimi laringeal mund te tregoje lezionate unilaterale dhe me se shumti bilaterale, por ato nuk jane simetrike ne madhesi. Enjtja nodulare akute dallohet nga nodujt, sepse ajo shpesh eshte fuziforme. Shume noduj te maturuar jane te vegjel, te zbehte, me pak fuziforme dhe ne perpjithesi shume simetrike, duke u vendosur perballe njeri-tjetrit. Videostrobolaringoskopija eshte shume here me sensitive per te diagnostikuar dhe differencuar lezionet laringeale, krahasuar me teknikat e tjera indirekte.

Trajtimi

Nodujt vokale duhet te trajtohen ne baze individuale duke u nisur nga mosha, profesioni, faktoret etiologjike dhe vecorite e ndryshme laringeale per cdo te semure. Kengetaret profesioniste me noduj te maturuar, te cilet kane ngjirje zeri per shkak te edemes, mund te rikthejne funksionin vokale ne rast se ulin perdorimin e zerit. Riedukimi vokal eshte pjese perberese e terapise ne te gjithe te semuret me noduj, sidomos kur mundesite kirurgjikale lihen ne fund. Ndonjehere nodujt vokale zhduken gjate terapise se te folurit. Jane gjithashtu te rendesishem menjanimi i ngacmuesve te laringut si dhe alergeneve. Persa i perket trajtimit kirurgjikal, autore te ndryshem kane publikuar teknika te ndryshme fonokirurgjikale per eksisionin e lezonave beninje. Akoma shume debate vazhdojne lidhur me meritat e metalit te ftohte perkundrejt lazerit me dioksid karboni. Te dyja teknikat mbartin potencialin e shkaktimit te gervishtjes me carje te lamina propriies. Lazeri ka edhe riskun e shtuar per demtim te indit periferik duke perhapur energji termike, duke shtuar keshtu rrezikun catastrofik potencial te zjarrit ne rruget ajrore. Gjate dekadave te fundit, preferencat editoriale kane tendencen te

favorizojne instrumentat metalik te ftohte, me rishke qe do ti nenshtrohen nderhyrjes kirurgjikale, duhet ti shpjegohet se zeri i tyre mund te behet me keq dhe rekurencat e lezionit jane te mundshme nese ata nuk respektojne terapine vokale, dmth abuzojne perseri me te folurin. Ne femijet nodujt vokale rralle trajtohen kirurgjikalish. Rekurencat ne femije jane te shpeshta per shkak te veshtiresive qe ka edukimi vokal i tyre, megjithate ne femijet nodujt zhduken rreth moshes se pubertetit.



Polipi vokal i lokalizuar

Ky lezion eshte per gjithesish unilaterale dhe ka një spekter te gjere prezantimi, qe nga haemorragjik ne edematoz, i pedunkuluar ne sesil dhe xhelatinoz ne te hialinizuar. Ne rastin e polipit, edhe pse eshte pasoje e fonotraumes, nuk eshte e nevojshme qe ajo te veproje per një kohe te gjate dhe shpesh shperthimi i lezionit me simptomat e tij mund te lidhet me një episod te vetem te sforcimit vokal apo me një episod te vetem haemorragjik. Gjithashtu polipi mund te shfaqet menjehere pas një infekzioni te rrugeve te siperme te frymemarrjes.

Patologjia

Patologjia lokalizohet ne shtresen e hapesires Reinke te kordave vokale te verteta. Demtimi konsiston ne ndryshimin e stromes edematoze, zgjerimin e eneve te gjakut, formimin e indit fibroz dhe haemorragjise. Me vone shfaqet degjenerimi fibrinoid dhe hialin ne stromen dhe muret e eneve te gjakut.


Manifestimet klinike

Ankesa kryesore eshte ngjirja e cila ndryshon ne varesi te madhesise dhe lokalizimit te polipit. Ndryshimi i zerit mund te varioje nga ngjirja ne afoni te plote, kur polipi prolabon nepermjet kordave vokale. Shpesh te semuret kane ndjenjen e një trupi te huaj ne fyt dhe vazhdimisht

bejne perpjekje per te pastruar fytin, por pa efekt. Polipi mund te shihet permes laringosopise indirekte. Demtimi eshte i njeanshem dhe vendoset ne te njejten pike te kordes vokale ku vendoset edhe noduli vokal. Ngjyra e nje polipi mund te jetë nga e kuqe e turbullt ose e ndritshme, ne te zbehte ose te verdhe. Duke qene se zakonisht polipi eshte unilateral, ne korden tjeter vokale shfaqet nje reaksiuni i vogel kontakti.

Trajtimi

I semuri duhet te observohet per pak javë dhe gjate kesaj kohe ai duhet te punoje me logopedin. Ne ndonje rast polipi mund te trajtohet vetem me masa koservative, megjithate shpesh eshte e nevojshme heqja nepermjet laringoskopise direkte nen anestezi gjenerale.



Polip i vendosur ne njeren prej kordave vokale

Edema Reinke


Njohur ndryshe edhe si degjenerimi polipoid, eshte enjtja e kordave vokale nga koleksioni fluid ne hapesiren Reinke. Shkaku kryesor i kesaj patologji eshte abuzimi vokal i vazhdueshem i shoqeruar me pirjen e duhanit. Po gjithashtu, ajo shkaktohet edhe nga RGE dhe ndryshimet hormonale, si psh hipotiroidizmi.

Manifestimet klinike

Simptomi me i shpeshte eshte ngjirja e zerit. Kjo ngjirje ndryshon me shkallen e edemes, ndersa afonia mund te shfaqet me nderprerje. Zeri eshte i ulet, monotonik dhe e ben te pamundur te kenduarin. Kur polipet jane te medha shfaqet dispnea dhe stridori dhe ne rate te rralla mund te ndodhe obstruksioni respirator i cili kerkon nderhyrje urgjente.

Trajtimi

Ne pacientet tek te cilet ky demtim diagnostikohet ne stadet e fillimit, mund te sjelle permiresim vetem terapia e zerit dhe menjanimi i ngacmuesve. Me shfaqjen e bllokimit te frysmares ose ne pacientet qe kerkonte nje ze me te mrie, keshillohet kirurgja. Heqja e polipeve mund te behet nepermjet nje incizioni paralel me buzen e lire te kordes vokale dhe nepermjet tij behet aspirimi i permbajtjes polipoide. Kujdes duhet treguar per rimbulin e mukozes mbi buzen e lire te kordes. Kur kjo nnderhyrje kombinohet me terapine e te folurit, ul rrezikun e formimit te membranave. Gjithashtu aplikohet edhe trajtimi me lazer.



Edema Reinke. Ekspansion bilateral i siperfaquesores lamina propria

Tipet e lezioneve hiperplazike

Pakidermia e laringut

Gjendje ne te cilen epiteli i komisures posteriore dhe i kordave te verteta posteriore i nenshtrohen procesit keratinizues. Nuk dihen shkqet e sakta, por dihet qe te gjithe ngacmuesit e laringut luajne rol ne kete semudje. Semundja eshte shume e shpeshte tek alkoolistet kronike dhe demtime te tilla jane gjetur pothuajse vetem ne burra. Gjithashtu ndikojne duhani dhe infekzionet respiratore kronike, por nje rol shume te rendesishem ka edhe RGE.

Patologjia

Mikroskopikisht shihet nje trashje uniforme e epitelit me dukuri te akantozes, parakeratozes dhe keratozes. Maturimi epitelial eshte i rregullt. Zakonisht mungojne diskeratoza dhe atipia

qelizore, ndersa reaksioni inflamatori subepitelial eshte i rralle. Pakidermia nuk konsiderohet patologji ku ndodh degjenerimi malinj.

Klinika

Shenja kryesore eshte ngjirja e zerit. Ekzaminimi i laringut zbulon nje mase te bardhe indore ne hapsiren interaritenoide qe mund te shtrihet ne kordat vokale. Kufijte e demtimit jane te ngritura dhe dallohet shume qarte viaje e demarkacionit. Kordat vokale zakonisht jane te trasha.

Trajtimi

Klasifikohet si nje demtim jo i shpeshte , prandaj nuk ka metoda te sakta terapie. Terapia lokale ka pak vlere. Gjithashtu pak efekt ne kete semudje kane edhe masat koservative, si pushimi relativ vokal, nderprerja e duhanit dhe alkoolit dhe trajtimi i RGE. Heqja kirurgjikale eshte e nevojshme vetem ne ata paciente te cilet kane demtime masive qe pengojne afrimin e kordave vokale dhe shkaktojne veshtiresi ne te folur. Eshte e detyrueshme biopsia per te perjashtuar proceset neoplazike ose ato infektive specifike.

Shtojca .1. (12)

Shkaktaret e laringitit nga inhalacioni:

Demtimi nga inhalacioni akut:	Avujt Gazrat e ngrohte e te thate Duhanpirja
Alergent e zakonshem:	Pluhurat Grimcat nga kafshet Formaldehidet Myku Pemet Bari Barerat e keqia
Ndotesit:	Ozoni Amoni Chlorin Oksidi nitrik Hydrogen disulfidet Dioksid sulfurik Monoksid i karbonit Acidi sufurik Acidi klorhidrik Insekticidet Pesticidet
Karcinogjenet e njojur:	Duhani Asbesti Radon Nikel Acidi sulfurik Vajrat e isopropilit Gazi mustard

Shtojca .2. ([13](#))

Trajtimi per laringitin nga refluksi

Niveli I : Terapia anti-refluks(ART)

A. Modifikimi I dietes

1. Mosngrenia dhe mospirja 3 ore para gjumit
 2. Shmangia e mbingrenies dhe shtrirjes direkt pas vaktit
 3. Jo te skuqura dhe jo ushqime te yndyrshme
 4. Shmangia e kafese, cajit, menteve, pijeve me gaz
 5. Shmangia e ushqimeve apo pijeve te tjera me permajtje kafeine
 6. Shmangia e alkoolit, kryesisht ne mbremje
 7. Shmangia e ushqimeve te tjera qe lidhen me problemin
- B. Modifikimi i stilit te jeteses
1. Ngritja e kokes se krevatit
 2. Shmangia e rrobaue te ngushta dhe rripave
 3. Stop duhanit
- C. Antiacide likide qid(1 luge pas cdo vakti dhe para gjumit)

Niveli II : Mjekimi plus ART

A. Niveli I plus B ose C

B. Trajtimi fillestar

1. Antagonistet e receptoret- H2 histaminik bid
- C. Pershkallezim ne rast deshtimi te terapise fillestare
 1. Rritja e dozes se terapise me anti-H2 qid ose
 2. Perdorimi i proton pump inhibitor (PPI)

Niveli III : Perdorimi i PPI ose i kirurgjise antirefluks

A. Niveli I minus antiacide dhe B ose C(me poshte)

B. PPI bid (doza e pare ne megjes dhe e dyta ne 5 pm; kohezgjatja e trajtimit te pare duhet te jete 6 muaj; pacientet trupmedhenje mund te kerkojne doza me te medha; Simptomat duhen te permirsohen pas 2 muajve te pare)

C. Kirurgji antirefluks (fundoplication)

Bibliografia:

1. Medscape, Stefano Berliti, MD, FACP Physician, Department of Medicine, Conquest Hospital, East Sussex NHS Trust, UK
2. Ahmed TF, Khandwala F, Abelson TI, Hicks DM, Richter JE, Milstein C, et al. Chronic laryngitis associated with gastroesophageal reflux: prospective assessment of differences in practice patterns between gastroenterologists and ENT physicians. *Am J Gastroenterol.* 2006 Mar. 101(3):470-8.
3. Fuchs M, Bücheler M. [Chronic hyperplastic laryngitis following treatment of hypertension with angiotensin converting enzyme-inhibitor]. *HNO.* 2004 Nov. 52(11):998-1000.
4. Kania RE, Hartl DM, Badoual C, Le Maignan C, Brasnu DF. Primary mucosa-associated lymphoid tissue (MALT) lymphoma of the larynx. *Head Neck.* 2005 Mar. 27(3):258-62.
5. Akhavan A, Ajalloueyan M, Ghanei M, Moharamzad Y. Late laryngeal findings in sulfur mustard poisoning. *Clin. Toxicol (Phila).* Feb. 2009. 47(2):142-4.
6. Hiraga A, Kamitsukasa I, Araki N, Yamamoto H. Hoarseness in pellagra. *J Clin Neurosci.* 2011 Jun. 18(6):870-1.
7. Witt DR, Chen H, Mielens JD, et al. Detection of chronic laryngitis due to laryngopharyngeal reflux using color and texture analysis of laryngoscopic images. *J Voice.* 2014 Jan. 28(1):98-105.
8. Oz F, Kalekoglu N, Karakullukçu B, Oztürk O, Oz B. Lipoid proteinosis of the larynx. *J Laryngol Otol.* 2002 Sep. 116(9):736-9.
9. Vaezi MF, Richter JE, Stasney CR, et al. Treatment of chronic posterior laryngitis with esomeprazole. *Laryngoscope.* February 2006. 116 (2):254-60.
10. Otorhinolaringología, Tirane 2000
11. El Uali Abeida M, Fernández Liesa R, Vallés Varela H, García Campayo J, Rueda Gormedino P, Ortiz García A. Study of the Influence of Psychological Factors in the Etiology of Vocal Nodules in Women. *J Voice.* 2011 Nov 14
Cipriani NA, Martin DE, Corey JP, Portugal L, Caballero N, Lester R, et al. The Clinicopathologic Spectrum of Benign Mass Lesions of the Vocal Fold due to Vocal Abuse. *Int J Surg Pathol.* 2011 Oct. 19(5):583-7.
Yamasaki R, Behlau M, Brasil Ode O, Yamashita H. MRI anatomical and morphological differences in the vocal tract between dysphonic and normal adult women. *J Voice.* 2011 Nov. 25(6):743-50.
12. Ballenger's Otorhinolaryngology 17, Head and Neck Surgery. Table 11: Causes of Inhalation Laryngitis, page 896.
13. Ballenger's Otorhinolaryngology 17, Head and Neck Surgery . Table 6: Treatment for Refluks Laryngitis, page 888.

